

Përse Allahu komunikon me ne nëpërmjet dikujt tjetër?

Nga punimet e Dr. Sultan el-Umejri

Disa që parashtrojnë këtë pyetje, synojnë t'i bëjnë vërejtje nocionit të peygamberllëkut duke pohuar se nocioni i një medium mes Allahut ﷺ dhe njerëzve bie ndesh me urtësinë dhe ndershmërinë. Gjëja duhur – thonë ata – është që Allahu vetë t'ua përcjellë drejtpërsëdrejti njerëzve atë çfarë do, pa ndonjë barrierë a pa ndonjë ndërmjetësues në mes.

Për më shumë – thonë ata – përse Allahu nuk u shfaqet nganjëherë njerëzve dhe t'u thotë çfarë do? Përse Allahu ﷺ nuk shpall kohë pas kohe një libër që do të sqaronte dhe shpjegonte çfarë do Ai nga njerëzit? Kur një mbret në këtë botë ka një porosi për njerëzit e tij, ua përcjell vetë dhe nuk dërgon tjetërkënd, përveç nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë ose është tepër i zënë.

Sidoqoftë, Allahu nuk është i këtillë. Edhe kjo vërejtja e dytë është e ngjashme me të parën në atë se përshkruan një nocion dhe përfundim të gabuar. Ky gabim ose ngatërrim mund të trajtohet si në vijim:

1. Kjo vërejtje injoron qëllimin e vështirësive në adhurim, meqenëse ato janë caktuar si një mjet për sprovimin e adhuruesit. Domethënë, sikur Allahu ﷺ të zbriste vetë – siç kërkojnë ata – ose të zbriste një libër drejtpërsëdrejti (nga qielli), kjo do të hiqte qëllimin e sprovës (dhe po ashtu të jetës), që është se njerëzit u krijuan për të adhuruar. Pas kësaj për ta do të ishte krejt njësoj dhe ata nuk do të shquheshin në të vepruar (shërbim, adhurim), gjë që mund të arrihet vetëm nëpërmjet lirisë së qëllimit dhe vullnetit. Kjo bie ndesh me faktin se Allahu ﷺ ka nderuar njerëzimin me barrën (vështirësinë) e cila ngre pozitën e tyre në botën tjetër nëpërmjet shpërblimeve të mëdha për dëgjueshmërinë e treguar.
2. Të bindësh njerëzit që të adhurojnë dhe t'i kushtohen moralit e vlerave kërkon një përpjekje të njëmendtë dhe një edukim të zorshëm. Është e domosdoshme që mësuesi t'u shpjegojë njerëzve çfarë kërkohet prej tyre, t'u tregojë si bëhet kjo dhe më pas të përgjigjet në pyetjet e tyre. Është e domosdoshme të vendosësh një shembull praktik të dhënies së fesë dhe kthimit të saj në një realitet praktik që njerëzit ta shohin me sytë e tyre. Këto kuptime mund të realizohen vetëm atëherë kur një peygamber të gjendet mes njerëzve.
3. Të gjitha çështjet e botës varen nga ndërveprimi mes shkaqeve dhe pasojave. Kështu, çdo ndodhi në botë - qoftë e madhe, qoftë e vogël; qoftë e rëndësishme, qoftë e parëndësishme - ndodh për një shkak. Allahu ﷻ i ka vendosur këto shkaqe me urtësi dhe ekzistenca e tyre nuk nënkupton që çështjet e botës funksionojnë si të pavarura (nga vullneti i Zotit). As peygamberllëku nuk dallon nga ndodhitë e tjera të botës shikuar nga ana e ndërveprimit, meqë Allahu është ai që bëri peygamberin një medium nëpërmjet

të cilit Ai komunikon me njerëzit për atë çfarë do prej tyre. Në këtë mënyrë Ai po ashtu bëri temperaturën e diellit një medium për nxjerrjen e shiut nga retë dhe gravitetin një bazë për mbrojtjen e sistemit të tokës.

4. Kjo vërejtje bazohet në një logjikë të gabuar, që bazohet në krenari, arrogancë e madhërim të vetvetes. Ai që bën këtë vërejtje, do që këtij kriteri t'i përmbahet edhe Allahu ﷻ. Kësisoj ai krijon urdhra për Allahun ﷻ, kurse kushtet e ndërlikuara për funksionimin e botës dhe veprimet e Allahut janë shumë larg arsytimit dhe mençurisë së Tij. Diskutimi rreth urtësisë hyjnore dhe sekreteve të veprimeve të Tij janë çështje të ndërlikuara, të cilat mendja e njeriut nuk mund t'i kapë. Ky person është sikur një i vogël mendja e të cilit asnjëherë s'mund të kuptojë tërësisht misteret e universit ku jeton. Atëherë, si është e mundur që ai të kuptojë të gjitha çështjet e Allahut në krijimin Tij dhe sekretet e menaxhimit të Tij! Ai që bën këtë vërejtje, është i verbër karshi kësaj logjike. Ai kufizon veten në supozimet e tija të paprovuara dhe të paragjykuara, pastaj vazhdon t'u bëjë vërejtje urdhrave dhe veprimeve të Allahut (!)
5. Ai që i bën vërejtje pejgmaberllëkut, vazhdon të krahasojë urdhrat e veprimet Allahut ﷻ si dhe menaxhimin e Tij të botës duke përdorur analogjinë e mbretërve të kësaj bote. Mirëpo, edhe kjo logjikë është e gabuar, meqë ne nuk shohim që një mbret të përcjellë vetë një mesazh të rëndësishëm. Ky është një përgjithësim i njëanshëm, që as nuk mbështetet nga provat, as nuk bazohet në një konkluzion të mirëfilltë logjik. Një mbret i jep një mesazh dikujt që ka pranë dhe i beson, i cili është inteligjent dhe vizionar. Një mbret nuk synon ta përcjellë vetë mesazhin, përveç nëse nuk i sheh si të besueshëm ministrat dhe as kujdestarët si të përshtatshëm për detyrën. Pra, shohim që pikëpamja e kritikëve se 'çdo mesazh i rëndësishëm përcillet nga vetë mbreti' është e pasaktë.